



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Këshilli Kombëtar i Ujit**

**V E N D I M**

**Nr 1 datë 25.11.2008**

**PËR**  
**FURNIZIMIN ME ZHAVORRE TË SUBJEKTIT QË NDËRTON**  
**SEKSIONIN LEVAN-VLORE**

Në mbështetje të neneve 6 e 20, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", dhe të studimit "Vlerësimi i pasojave, ndikimit mjedisor, problemeve hidrodinamike dhe rehabilitimi i gjendjes në shtretërit e lumenjve", të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

**V E N D O S I:**

1. Lejimin e shfrytëzimit të inerteve lumore në basenin e lumit Vjosa, për periudhën 25 nentor 2008 – 1 qershor 2009, për nevoja të ndërtimit të seksionit Levan-Vlore, duke respektuar studimin e miratuar për shfrytëzim dhe duke bërë rehabilitimin e zones së shfrytëzuar, e parandaluar çdo impakt mjedisor negativ.
2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhëse Seman e Vjosë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BALI BERISHA**

**ZEVENDESKRYETARI**

  
**LUFTËR XHUVANI**